



VENDIM

Nr. 11, Datë 19.01.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“BALCAN ENERGY TRADE” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma ”d” të Ligjit nr. 43/2015, ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të neneve 4, gërma “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 gjithashtu dhe nenit 19, pika 1, gërma ”a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licensimin e shoqërisë “Balcan Energy Trade” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë ”Balcan Energy Trade” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për Proçedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 si më poshtë:

Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat ”a”, ”b” dhe ”c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat ”a”, ”b”, ”c”, ”d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat ”a”, ”b”, ”d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Të dhënat specifike të liçensës (neni 9, pikat 4/8 gërmat ”a”, ”cv dhe ”d”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Të dhënat specifike të liçensës (neni 9, pikat 4/8 gërma ”b”), do të njoftohet aplikuesi që ti paraqesë në ERE brenda afateve ligjore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licensimin e shoqërisë “Balcan Energy Trade” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI